



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040, nenit 8 deri në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016 nga MAPL, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe nenit 6, 7 dhe 9 të Rregullores komunale për Komitete Konsultative /2012, si dhe vendimit të Kuvendit të Klinës, nr.0106-48533/19 të dt.04.12/2019, Kuvendi i Komunës së Klinës vendosi, të shpall:

**KONKURS PUBLIK
PËR ANTARËSIMIN NË KOMITETIN KONSULTATIV TË KOMUNËS**

Zgjedhja e një anëtari për Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

KUSHTET DHE KRITERET E ANËTARËSIMIT

Anëtari i Komitetit konsultative duhet t'i përmbush këto kritere:

1. Të jetë banorë i Komunës së Klinës,
 2. Të kenë përgatitjen superiore-profesionale të fushës përkatëse,
 3. Të këtë përvojë pune,
 4. Të drejtë aplikacioni kanë qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.
- Në këto komitete duhet të merret në konsideratë barazia gjinore.

PËRSHKRIMI I PUNËVE :

Anëtarët e Komiteteve Konsultative duhet të kenë aftësi për paraqitjen e ideve, mendimeve dhe hulumtimeve si dhe dhënien e propozimeve të ndryshme për rregullativa komunale dhe iniciativave të ndërmarra nga organet komunale, Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës. Duhet të hartojnë planin e punës dhe kalendarin për takime për secilin vit, në të cilin duhet të përfshijnë takimet e rregullta me Kuvendin e Komunës si dhe takime të rregullta me Kryetarin e Komunës, të dorëzojnë raport vjetor për punën e vet Kuvendit.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Aplikacioni merret në Shërbimin për punë të Kuvendit duke ia bashkangjitur dokumentet tjera si në vijim:
Diploma, Ekstrakti i lindjes dhe Letërnjoftimi i fotokopjuar.

Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është katër (4) vjeçar nga themelimi i komitetit dhe nuk mund të shërbejnë me shumë së dy mandate të njëpasnjëshme.
Komitetet mbajnë së paku gjashtë takime (6) në vit dhe kompensohen nga buxheti i komunës jo më shumë së për gjashtë (6) takime në vit.
Kompensimi duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Paneli intervistues i propozon Kuvendit të Komunës për miratim listën e kandidatit të mundshëm.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Kuvendit nr.3 në objektin e Komunës së Klinës, rruga "Abedin Rexha" Klinë

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 111-21981 2020
Klinë, më 12.04 2020



Kryesuesi,
Fadil Gashi